



Kalendari i dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë për buxhetin e vitit 2023 dhe KAB-it për vitet 2024-2025

Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, si dhe nenit 6 pika 1.3 UA (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Drejtoria për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me Zyrën për Informim, publikojnë kalendarin për organizimin e dëgjimeve publike me qytetarë për buxhetin e vitit 2023 dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), për vitet 2024-2025.

Nr	Vendi i mbajtjes së dëgjimit	Data/dita e mbajtjes së dëgjimit	Ora
1	Dëgjimi Publik në Sallën e Kuvendit <i>Me Organizatat Joqeveritare që veprojnë në komunën e Rahovecit</i>	15 gusht 2022 E hënë	10.00
2	Dëgjimi Publik në Sallën e Kuvendit <i>Me bizneset dhe grupet e interesit</i>	16 gusht 2022 E martë	11.00
3	Dëgjimi Publik në Sallën e Kuvendit <i>Buxhetimi Gjikor</i>	17 gusht 2022 E mërkurë	11.00
4	Dëgjimi Publik në Shtëpinë e Kulturës "Mensur Zyberaj"-Rahovec <i>Dëgjim publik përmbledhës me bashkësitë lokale dhe lagjet urbane, me përfaqësues të shkollave dhe rininë</i>	18 gusht 2022 E enjte	10.00

Në dëgjime buxhetore publike mund të marrin pjesë : Qytetarët, përfaqësuesit e lagjeve/bashkësive lokale, përfaqësuesit e OJQ-ve, përfaqësuesit e komuniteteve, të rinjtë, gratë, pensionistët, studentët, komuniteti i biznesit, përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme, përfaqësuesit e ndërmarrjeve publike, anëtarë/e të Kuvendit Komunal të Rahovecit, deputet/e, punonjësit e komunës, përfaqësuesit e partive politike dhe përfaqësuesit e mediave.

Informacionet për qarkoret buxhetore dhe buxhetin e vitit 2023, mund t'i gjeni në këto vegza:

Webfaqja zyrtare e komunës:

<https://kk.rks-gov.net/rahovec/category/financat/>

Platforma e Konsultimeve publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/>

Kërkesat, komentet dhe sugjerimet, qytetarët mund t'i dërgoni edhe përmes këtyre emailave: ekrem.bytyqi@rks-gov.net dhe blerta.gashi@rks-gov.net

Afrim Limani

Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa